

PROBLEME E DISKUTIME

BARDHYL DEMIRAJ

RRETH ZHVILLIMIT TË SPIRANTES ie. */s/ NË GJUHËN SHQIPE

Fonema */s/ në fjalët shqipe me burim indoевropian (=ie.) u është nënshtruar qysh herët zhvillimeve të ndryshme fonologjike, të cilat jo në çdo rast përputhen me shndërrimet e mëvonshme që ka pësuar kjo fonemë në njësitë me burim të huaj të kësaj gjuhe, sado i vjetër qoftë ai¹.

Në hulumtimet fonologjike në fushë të shqipes, qysh nga G.Majeri e këtej, janë pranuar deri katër reflekse të fonemës ie. */s/; a) */s/ → shq. /ʃ/ : */septm/ > shq. *shtatë* */sek^v-sko-/ (temë e aoristik) > shq. *shoh*, */^hisem/ > shq. *jeshë*; b) */s/ → shq. /θ/ në dy raste : */sūs/ > shq. *thi*, */sausnjo-/ > shq. *thanj, thaj* ; c) */s/ → shq. /g/ : */seks-/ > shq. *gjashtë*, */solgo-/ > shq. (i) *gjallë*, */soko-/ > shq. *gjak*, */supno-/ > shq. *gjumë*, */sinu-/ > shq. *gji*, */serpen/ > shq. *gjarpër* etj.; d) */s/ → shq. /h/ : */solkjō-/ > shq. *heq* (?), */sūlno-/ > shq. (h)yll (?), */sodinjō-/ > shq. *hyj* (?) etj³.

Për vendosjen e irregullsive fonologjike dhe kronologjike të këtyre shndërrimeve mendimet e historianëve të shqipes nuk bashkohen. Në qerthullin e tyre, vend qendror zë teza e Pedersenit që i sheh të katër reflekset e spirantes ie. */s/ si zhvillime të brendshme të shqipes. Në punimin e tij të mirën johur *Die Gutturale im Albanesischen*, ai paashton edhe tezën e vet mbi zhvillimin e kësaj spirante

1) Fonema /s/ që ka depërtuar në shqipe prej gjuhëve të ndryshme qysh prej periudhës antike është ezauruar tashmë nga historianët e kësaj gjuhe. Në to vihen re dy zhvillime të diferençuara në kohë */s/→shq. /ʃ/ deri në shek. X e.r. dhe */s/→shq. /s/ pas këtij shekulli. Shih përf këto dukuri E.Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1960, f. 120

2) Shih, ndërsë të tjerrë, G.Meyer, AS III, f. 40v.; H.Pedersen, *Die Gutturale im Albanesischen*, KZ 36, 1900, f.277 v.; V.Pisani, *Albanica*, «Revue des Etudes Indoeuropéennes» 4, Fasc.1-2, 1947, f. 5v. ; M.La Piana, *Studi I*, f.26v. ; H.Barić, «Hymje në historinë e gjuhës shqipe», Prishtinë 1955, f.12; E.Çabej në vendin e cituar; E.H. mp, «Evidence for laryngals», 1960, f.73v.

M.Huld, *Basic albanian etymologies*, Los Angelos, 1984, f.147.

3) Këtu kemi lënë jashtë vështrimit ato raste kur fonema */s/ del në bashkëvajtje me një bashkëtingëllorë tjetër. G.Meyer, AS III, 62.

t

eje në gjuhën shqipe. Sipas tij, refleksi ie. */s/ → shq. /ʃ/ është paliesor në pikëpamje kronologjike (periudha I e shqipes). Brenda kësaj periudhe, fonema e përfshuar /ʃ/ realizohet edhe në alofonin e saj të zëshëm /ʒ/ në ato raste kur theksi binte mbi zanoren ndjekëse të po asaj rrokjeje. Që këtej, këto alofone, kur fituan statusin e fonemave të veçanta (periudha II e shqipes) iu nënshtruan zhvillimeve fonologjike të ndryshme. Fonema /ʒ/ u zhvillua rregullisht në /g/ pavarësisht nga timbri i zanores ndjekëse: */séks/ > shq. *gjashtë*; */süpnɔ-/ > shq. *gjumë*. Ndërsa fonema /ʃ/, sipas tij, u ruajt para zanoreve të çelta (/e/, /i/): */septm/ > shq.

shtatë etj. dhe u shndërrua në /h/ para zanoreve të myllura (/a/, /o/, /u/): */sūl nō/(?) > shq. *hyll* etj. Për sa i takon reflekxit ie. */s/ → shq. /v/ shq ai pranon tezën e G.Majerit që përsiat këtu një dukuri sporadike disimilimi të shkaktuar nga prania e një spiranteje të dytë në trup të fjalës: */sūs/ > shq. *thi*, */saʊsnjō-/ > shq. *thanj* (*thaj*)⁴. Kjo gjendje përaqitet për Pedersenin e përfunduar në periudhën para ndikimit latin mbi shqipen (periudha III e shqipes).

Siq shihet, në teorinë e Pedersenit mbi zhvillimin e spirantes ie. */s/ në shqipe rol vendimtar luan vendi origjinar i theksit. Ky kusht tonemik për dukurinë në shqyrtim e ruan vlerën e vet në fonologjinë historike të shqipes. Nga ana tjetër, Pederseni i pranëvendos këtij kushti edhe atë fonologjik, kur përpinqet të shpjegojë dysinë e reflekseve të supozuara (*s/ → shq./ʃ/ dhe /h/) vetëm për njëin krah të kundërvëniez *i theksuar ~ i patheksuar*. Veçse në këtë rast ai është i ndërgjegjshëm se një numër shembujsh nuk u përshtaten më rregullave të vendosura prej tij.

Këto vështirësi i kanë ndeshur edhe gjuhëtarë të ndryshëm albanologë, të mëparshëm dhe të mëvonshëm, të cilët janë përpjekur të jepin të tjera shpjegime. Vëmendja kryesore është përqendruar në reflekxin e lëkundur ie. */s/ → shq. /h/. Kështu, G.Majeri në AS III, f.56, pasi heton edhe në sllavishten e vjetër dhe në greqishten raste të ngjashme të zhvillimit binar të ie. */s/ në /ʃ/ dhe /h/ brenda të njëjtë kusht tonemik vjen, në përfundimin se «Shpjigimi duhet të kërkohet në përzierjen e vjetër të dialekteve (=gjuhëve ie. — B.D.). Vala që shndërroi s-në e arishtes para një zanoreje në h në arishten peiendimore (iranishten), ngértheu thuaqse të gjithë greqishten, por që nuk u ndal në kufijtë më të largët të arealit gjuhësor grek të vjetër. Ajo ushtroi veprimin e saj pjesërisht edhe në arealat gjuhësore ilire dhe sllave». Këtë idë e gjemjë edhe te M.La Piana, i cili e men don reflekxin ie. */s/ → shq. /h/ si gjurmë të elementit *centum* të shqipes⁵. dhe te V.Pisani që përsiat një izoglosë iliri-greke me pikënisje nga greqishtja e vjetër⁶. E.Çabej e quan të hapur këtë problem për një numër njësish leksikore⁷. Ndërsa E.Hempji dhe M.Huldhi venë në dyshim reflekxin */s/-/h/ në pozicion nistor.^{7/1}

Siq del edhe nga parashtrimi i përbledhur i këtyre tezave, kushti fonologjik që i është mbivendosur atij tonemik vazhdon ende të jetë i diskutueshëm. Prandaj në këtë punim vëzhgimi është përqendruar kryesisht në vërtetësinë e këtij kriteri.

Analiza e materialit gjuhësor të çon në një ndryshim të pjesshëm të tezes së Pedersenit mbi zhvillimin e spirantes ie. */s/ në këtë gjuhë. Duke përdorur metodën e përjashtimit në faktet gjuhësore të sjella për krahasim, vërejmë se

4) Shih G.Meyer, AS III, f.42.

5) M.La Piana, *vep.cit.*, f.29.

6) V.Pisani, *art.cit.*, f.10.

7) E.Çabej në vendin e cituar.

7/1) E.Hamp dhe M.Huld në vendin e cituar.

mbishtiesimi i kushtit fonologjik vetëm në njërin krah të kundërvëniec i theksuar ~ i patheksuar nuk arrin të motivohet bindshëm në disa drejtime.

Në kushte tonemike të ngjashme zhvillimi ie. */s/ → shq. /ʃ/ vërtetohet edhe në pozicion para zanoreve të prapme. Përmendim këtu ndër të tjera:

a) Mbatesa e rasës vendore shumës ie. */-su/ eshtë shndërruar në shqipen e sotme në shenjuesin e rasës rrjetdhore -sh.⁸

b) Njësia *shi*. Në trajtimin etimologjik të kësaj fjale⁹ eshtë vërejtur përgjithësisht afëria e saj me gr. υει «bie shi», υετο «shi i fortë»; ind.vj.sū-; prus. vj.soye; tok.A. swasé B.swese, të gjitha me kuptimin «shi» nga baza ie. */ seū-/, */sū-/ «lëng». Fjala shqipe mund të shpjegohet më fort si një plurale tantum me formë të rindërtuar në shkallë apofonike zero */sū-oi/. Kjo formë nuk vjen në kundërshtim me vokalizimin /i/ të njësisë së sotme.¹⁰

c) Emri *shatë* «almise bujqësore», për të cilin eshtë pranuar etimologjia e G.Majerit që rindërton një paraformë */sek-tV-/ me shndërrimet e rregullta të zanores rrëniore */e/ → shq./ie/ → /ja/ (→ /a/). Por ky rindërtim bie për shkak të kriterit tonemik që parakupton shndërrrimi i spirantes nistore. Në kushtet e mungesës së theksit të rrokjes nistore, timbri i zanores së sotme /a/ mund të shpjegohet vetëm me praniënë në rrënjen e fjalës (që rezulton me shkallë apofonike zero) të një foneme zanore me timbër drejt /a/-së. Dhe këto i përbush rindërtimi i një paraformë */sek-tV-/ me zanoren e reduktuar Schwa secundim *¹¹.

d) Shndërrimi ie. */s/ → shq./ʃ/ dëshmohet edhe në pozicionin para sonanteve hundore */n/, +/m/. Krahaso për këtë qëllim të pakryerën e foljes «jam» veta I nj. : jeshē > ie. */h₁ésm/, ku /-m/ përfaqëson mbareës dytësore në fojet e zgjedhimit në */mi¹²/.

Të gjithë këta shembuj, megjithëse të pakët në numër i lëkundin pozitat e kushtit fonologjik që shqyrtuan më sipër.

Ky përfundim përfundohet edhe më shumë, kur merret në analizë zhvillimi fonologjik i supozuar ie. */s/ → shq./h/. Le të shqyrtojmë nga afër për këtë qëllim etimologjinë e atyre fjalëve të trashëguara që mendohet të janë shembujt më të sigurt të këtij zhvillimi.

a) Folja *heq* eshtë ndër njësitë e trajtuar më shumë në studimet etimologjike të shqipes. Si forma më arkaik e fjalës cilësohet *helq*, *holqa*¹³ që del sot e rrudhuri në përdorim në disa të folme konservatore të dialektit tosk e të diasporës shqiptare me bazë këtë dialekt¹⁴: çam.*helq*, salam.*helq.*, Vakarico (Kal. *yelq*.

Që nga G.Majeri¹⁵, *helq* eshtë krahasuar me gr. ἥλω «heq, tērheq», lat. *sulcus* «vijë, brazdë», angl.vj.*sulh* «brazdë» duke rindërtuar një bazë të përbash-

8) Shih H.Pedersen, *art.cit.*, f. 280, 310.

9) Shih ndër të tjerrë G.Meyer, EWA, f.405; H.Pedersen, *art.cit.*, f.281; V.Pisani, *art.cit.*, f.12; J.Pokorny, IEW I, f. 912; E.Çabej, SF 1,1966, f.19; E.Hamp, *O.Pruß soye* «rain», KZ 74, f.108; M.Huld, *vep. cit.*, f.113.

10) Shih G.Meyer, AS III, f.30; H.Pedersen, *art.cit.*, f.282, 340.

11) Shih më gjerë për praniënë dhe zhvillimin e zanores së reduktuar *_e në gjuhën shqipe B.Demiraj, *Çështje të trajtimit diakronik të numërorit katër*. SF 3,1989, f.94v.

12) Shih O.Szemerényi, *Einführung in die vergleichende Sprachwissenschaft*, Darmstadt, 1980, f.215.

13) Për karakterin autokton të foljeve që dëshmojnë apofoni në gjuhën shqipe, shih Sh.Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985, f.91 v.

14) Shih H.Pedersen, *Albanesische Texte*, Leipzig, 1895, f.132.

15) G.Meyer, AS III, f.43; EWA f.151; H.Pedersen, *Guiturale*, f.278; E.Boisacq, DELG, f.244; E.Çabej, SE, fjala *heq* (ë pabotuar)

kët **suelk-*, **selk-*, **solk*¹⁶. Nga ky mendimi i përgjithshëm është larguar së pari E.Hemp¹⁷ që e lidh trajtën shqipe me gr. *άέλκω (?) duke rindërtuar një **A₁ u-olkejō*. Ky rindërtim paraqitet i vështirë për M.Hludin¹⁸, i cili supozon një paraformë **A₂ olqejo A₁* dhe e lidh farefisnisht me angl.vj. *calh* «tempull, vend i shenjtë» me prejardhje kuptimore nga «pastroj».

Ndër supozimet e parashtruara, ai i M.Huldit mbetet tepër i vështirë për t'u pranuar edhe për shkaqe semantike. Për arsyen fonologjike, vështirë se mund të mbështeten edhe bazat e rindërtuara **solkejō-*, **selkjō-*, të cilat nuk e moivojnë sa duhet vokalizmin e formës së sotme¹⁹.

Interes paraqet edhe mendimi i E.Hempit, i cili sjell për krahasim një formë të rindërtuar pa *s-* nistore, pavarësisht nga shembulli dhe forma bazë që rindërtion.

Vështrimin e formës bazë /**suelk-*/ me një *s-mobile*²⁰ e mbështet plotësisht edhe baza tjetër ie. e rindërtuar /**uelk-*/ «heq, têrheq, plugoj, bëj brazdë», që dëshmohet në lit.*velku*; sll.vj.*vleka* «têrheq (zvarri)»; av.*varək-* «têrheq»; gr. ἄ(F)ολξ etj.²¹. Në këtë rast, një lidhje etimologjike midis bashkëtingëllorës së aspiruar /h/ te *heq*, *helq* dhe gjysmëzanores /**u*/ (**uelkjō*) është e mundur vetëm në kushtet e mungesës së theksit mbi zanoren e rrënjes. Përndryshe ajo mund të shpjegohet fare mirë edhe si një tingull inorganik.

Shpjegimi i fonemës /h/ te kjo njësi me një laringal (/A₂/) është tepër i vështirë për t'u pranuar me dijen e derisotme gjuhësore.

Krethana të ngjashme fonologjike vërehen edhe në një numër njësish të tjera, si (h)*iki* < që mendohet të jetë përfshuar nga forma mediopasive e foljes *heq*, *helq*²² dhe (h)*ec* < ie. /**uendhjō-*/ «largo hem, zhdukem» etj.

b) Krahas foljes *heq*, *helq* edhe emri (h)*yll* është vështruar në përgjithësi si një nga dëshmitë e pakta të reflekxit ie. /*s/ → shq/h/. Por probleme të veçanta që kanë të bëjnë me etimologjinë dhe me trajtën përfaqësuese të kësaj fjale vazhdojnë të ngjallin diskutime edhe sot e gjithë ditën.

Thuajse të gjithë studiuesit e shqipes që janë marrë me këtë problem, nisen nga trajta përfaqësuese /(h)ył/, megjithëse në të folme të ndryshme dialektore dhe të diasporës si edhe në tekstet e autorëve të vjetër dëshmohet një larmi variantesh: Buzukı, ყill; Budi, e Bardhi *yll*; Bogdani, *hyj*; në të folmet dialektore, t.jug. *il*; Kavalioti, *ull*; arb.siq.izë; g.veri-lind. *uvill* etj. Një pjesë të këtyre variantave, siç janë format me /u/ ose me /l/ palatale, E Çabej²³ i mendon si shumësa të singularizuar të (h)*yll*-it në këto të folme. Si një formim të tillë me derivacion kuptimor E.Çabej mendon edhe formën *hyj* «zot, perëndi» që del te Bogdani. Këtë ai e shpjegon si një neologizëm të atij autorit.

Lidhur me etimologjinë e fjalës, janë pranuar thuajse nga të gjithë studiuesit e shqipes format e rindërtuara nga G.Majeri dhe të përmirësuara më vonë nga H.Pederseni ie. /*sülo-/ /*süli-²⁴ të krahasuara me ir.vj.*süil* «sy»; ind.vj.

16) Shih J.Pokorný, IEW I, f.901.

17) E.Hamp, *Evidence for laryngals*, 1960, f.72 v.

18) M.Huld, *vep.cit.*, f. 73.

19) Forma /**selkio*/ vjen në kundërshtim me rregullën fonologjike të supozuar /*s/ → shq./h/ / — /a/ (/o/, /u/) (shih më sipër); ndërsa /**solkejō*-/ nuk motivon zanoren rrëniore.

20) Shih për praninë e *s-mobile*, O.Szemerényi, *vep.cit.*, f. 87.

21) Shih J.Pokorný, IEW I, f.1145.

22) E.Çabej, SE, fjalë *iki* (e pabotuar)

23) E.Çabej, SE, fjalët *hyj* dhe *hyll* (të pabot.).

24) Shih G.Mayer, EWA, f. 460, AS III, f.43; H.Pedersen, *art.cit.*, f. 278 etj.

25) Shih për këtë bazë J.Pokorný, IEW, I, f. 381, 1045v.

sūrah «perëndi»; sll.vj. s/ънъце «diell». Në themel të kësaj etimologjje qëndron lidhja semantike midis «yll» dhe «diell», e cila mbështetet në bazën ie. */suəl/, */suel/, */sūl-/ «diell»²⁵. Kohët e fundit, M.Huldi²⁶ propozon një zgjidhje tjetër etimologjike. Ai vendos lidhje semantike midis «yll» dhe «shkëndijë, urë zjari» që e sjell nga baza ie. */eұs-/ «ndez» dhe e krahason me noid.vj.usli «shkëndijë, urë zjari»; angl.vj. *ysle*; gjerm.mes.lartë. usl(e) etj., duke iindërtuar një paraformë */usli-/.

Një zgjidhje e kësaj dysie etimologjike këïkon që analiza e materialit gjuhësor të jetë shumëplanshe, duke përfshire njëherësh aspektin semantik, fonologjik dhe gramatikor të problemit.

Në planin semantik, të dyja etimologjite duket të janë të motivueshme, pasi për të dyja qëndron në thelbin nocioni i «diçkaje që ndizet, që digjet pa flakë». Ndërkakq atrimi me bazën ie. */suel-/ . */sūl-, çon në një farë ndeshjeje midis nociioneve «diell» dhe «yll». Për rastin tonë: dy trupa qiellore të emërtuar mbi bazën e vetisë së ndriçimit, të rdejzes, vështirë se mund të janë zhvilluar në të njëjtën gjuhë dy variante të së njëjtës bazë: */suel-/ «diell» dhe */sūl-/ «yll». Këto dy variante mund të motivoreshin, deri diku, vetëm për arsyen gramatikore : në rastin konkret, të pranohet ie. */suel-/ si temë e numrit njëjës : «diell» dhe */sūl-/ si temë e shumësit : «yje». Sa për afiimin me formën ie. */usli-/ «urë zjari, shkëndijë», këtu nuk paraqitet ndonjë problem semantik. Nocioni «yll» shpjegohet në këtë rast me një prejardhje semantike brenda shqipes.

Edhe në planin gramatikor-morfonologjik format e rindërtuara */sūlo-/, */sūli-/ paraqesin disa vështirësi, pasi nuk del e motivuar për shqipen gjatësia e zanores së rrënjes në marrëdhëni gramatikore midis *diell* ~ (*h*)*yll* dhe ie. */suel-/ ~ */sūl-/²⁷. Kurse forma e rindërtuar */usli-/ nuk nxjerr probleme edhe në këtë plan. Ajo paraqitet si një formim me formantin */-li-/²⁸ nga baza follore ie. */eұs-/ «djeg, ndez» në shkallën apofonike zero.

Në planin fonologjik të dyja etimologjitetë ndeshin në vështirësi interpretimi. Krahas burimit të gjatësisë së zanores së rrënjes te format */sūlo/, */sūli/ (shih më lart), vështirësi jo të vogla karakterizojnë edhe formën e rindërtuar */usli/. Lidhjen e saj me formën e sotme /ył/, M.Huldi e shpjegon nëpërmjet zhvillimit të grupit */sl/ → shq./l/ si edhe metafonisë /u/ : /y/ në rrënjen e fjalës, të shkaktuar nga zanorja /i/ e rrokjes ndjekëse.³⁰ Në këtë rast, mbetet për t'u shpjeguar vetë fati i zanores /i/ te formanti ie. */li/ i supozuar. Një bjerije e mundshme e saj, pasi të kishte shkaktuar metafoninë /u/ : /y/ do të shoqërohej me zhvillime të tjera fonologjike në pjesën fundore të njësisë. Është fjalë këtu për palatalizimin në /j/ të likuidës velare /l/ ose të thjeshtë /l/ në pozicion para zanoreve */i/, */l/ ose gjysmëzanores /j/³¹ : *bijē* < **bilja*, formimet e shumësit *diej* (*diell*), *shuaj* (*shuall*), *buaj* (*buall*) etj., të shkaktuara nga formanti i shumësit */-i/³² etj. Veprimi i kësaj

26) Shih M.Huld, *vep.cit.*, f.132

27) Shih për zhvillimin e grupit */su/ para një zanoreje e bashkë me të edhe etimologjinë fjalës *diell*, H.Pedersen, *art.cit.*, f. 286.

28) Një shkallë apofonike zero e supozuar, në këtë rast, do të motivonte vetëm timbrin e zanores së rrënjes.

29) Shih përfunkcionet e këtij formanti, K.Brugmann, *Grundriss*, II, f. 381.

30) Shih për këto shndërrime edhe E.Çabej, *Hyrje*, f. 97, 121.

Shih për kushtet tonemike në përfstimin e metafonisë, SH. Demiraj, *vep.cit.*, f. 66.

31) Shih për këtë dukuri G.Meyer, AS III, f.75 v ; H.Pedersen, *Alb. 1-Laute*, KZ 33, f. 535v.

E.Çabej, *Hyrje*, f. 117

32) Shih për shënjuesin e shumësit */i/, Sh.Demiraj, *vep.cit.*, 276.

dukurie edhe në formimin e shumësit të vetë njësisë në shqyrtim *yll* : *yj(e)* e vësh-tirëson edhe më fort interpretimin e etimologjik të M.Huldit³³.

Duke u nisur nga interpretimi etimologjik i M.Huldit gjjejmë më të mbësh-tetur një formë : *ē* rindërtuar **/uslo-/* po me kuptimin zanafillës «urë zjarri» shkëndëjë» dhe të përfstuar nga baza irëniore **/eūs-/* «djeg, ndez» me formantin ie. **/-lo/*³⁴, që është sinonim për nga funksioni gramatikor dhe semantik me formantin tjetër ie. **/-li/*. Përnjasimi i bërë në këtë rast midis **/uslo-/* : *shq./ył/* dhe *shq. /y/* te format në shqyrtim mund të shpjegohet me një gjatësi kompen-satore³⁵. Po të marim në analizë strukturën burimore të rindërtuar ie. **/uslo-/* vërejmë se ky kusht plotësohet me bjerrjen e spirantes **/s/* në pozicion para li-kuidës së thjeshtë */l/*³⁶. Në këtë pikë njësia në shqyrtim nuk përbën një rast të veçantë për shqipen. Gjatësinë kompensatore të shkaktuar nga bjerra e spirantes

**/s/* e vërejmë edhe në njësi të tjera si *kollë* < ie. **/k^vas-lo-/*³⁷ me shkallën ndërmjetëse */kālo/*; *dyllë* < ie. **/g^vhuslo-/*³⁸, me shkallë ndërmjetëse **/dūlo-/*.

Duke u nisur nga këto përfundime që dalin nga analiza fonologjike e njësisë në shqyrtim, mund të vendoset një vijimësi kronologjike me format e rindërtuara dhe të dëshmuara: ie. **/(h₁)uslo-/* > [°]*ūla/* > */ył/*.

Sic del edhe nga ky trajtim etimologjik i përbledhur i njësisë *yll* vështirë se ajo mund të sillet si një shembëllzim i sigurtë i zhvillimit fonologjik të supozuar ie. **/s/* → *shq. /h/* — / *a/(o, /u/)* — . Nistorja */h/* që del në mënyrë sporadike për këtë njësi, në ndonjë të folme konservatorore, shpjegohet si shtesë inorganike që shfaqet shpesh në këto të folme për njësi të ndryshme që nisin me *zanore*³⁹: *hamëshor* < lat.*admissarius* ; *harabel* < sll.*jug.vrabel* ; *hamullore* < [°]*a-mull* «e pambjellë».

I njëjti problem del edhe në trajtimin diakronik të njësisë *kohë*. Pjesa më e madhe e studiuesve të shqipes kanë sjellë për krahasim sll.vj. *časъ* «*kohë*», rus. *čas* «*kohë, orë*», duke rindërtuar për të një paraformë **kēsā* (?⁴⁰).

Pa dashur të ndalemi gjatë në etimologjinë tepër të vështirë të këtë aj fjale, mendojmë se baza **kēsā* duhet për ja shqiptuar edhe përfaktin se një ie. **/s/* ndëri-zanore në gjuhën shqipe ka dhënë rregullisht */ʃ/* : *jeshë* < ie. **/h₁esm/*; iasa rrje-dhore shumës *-sh* < ie. **/-su/* ; gjurmët e aoristit sigmatik më **/s/* në shqipen⁴¹ etj.

Tepër e vështirë për t'u sqaruar mbetet sot për sot edhe etimologjia e fjalës

33) Forma e rindërtuar prej tij mund të motivohej vetëm në rast se një paraformë */yj/* e përfstuar për njëjtin do të ndjehej si formë e shumësit dhe me kalimin e kohës do të rikrijonte një formë të re për numrin njësës. Por një supozim i tillë shtron probleme të tjera, që mbeten sot pësot të pakapërcyeshme.

34) Shih për këtë formant në ie., K.Brugmann, *Grundriss*, II, 1,360. Për përfaqësimin tij në shqipe, shih A.Xhvani-E.Çabej, *Prapashesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, f. 67.

35) Për zhvillimin **/ū/* > */y/* shih H.Pedersen, *Gutturale*, f.340.

36) Shih G.Meyer, AS III, f.63

37) Shih për këtë bazë dhe rrjedhojat e saj në ie., J.Pokorny, IEW, I, f. 649; për shqipen shih G.Meyer, EWA, f. 195; E.Çabej, *Hyrje*, f.121.

38) Shih për bazën **/g'heu(s)-/* «*rjedh*» dhe rrjedhojat e saj, J.Pokorny, IEW I, f. 447. Për shqipen G.Meyer, EWA, f. 78 etj.

39) Shih për këto njësi G.Meyer, në EWA dhe E.Çabej në «*Stud.gjuh.*» I, II.

40) Shih ndër të tjerë G.Meyer, EWA , f.194; H.Pedersen, *art.cit.* 280. M.Huld, *vep.cit.*, f.81. Por ka edhe studiues të tjerë që e shpjegojnë këtë njësi me grupin **/ks/*/sk/* (V.Pisani, *art. cit.*, f.6..

41) Shih G.Meyer, AS III, f.61; Sh.Demiraj, *Gramatikë*, f.784.

hyj, hyn. Larmia e formave të rindërtuara për këtë njësi : **sūpniō* (?)⁴², **sodinio* (?)⁴³, **A₂u-nioA₂*⁴⁴ (?) nuk përputhet me të dhënat e fonologjisë historike të shqipes dhe të indoevropianistikës. Përveç mungesës së rindërtimeve të tillë në gjuhën bazë dhe në gjuhët e ndryshme ie., del edhe vështirësia e motivimit të vokalizmit të rrënjes /y/.

Të gjithë këta shembuj që morën përbledhtas në analizë zojn se mund të dëshmojnë sigurinë e shndërrimit fonologjik të supozuar ie. */s/ → shq. /h/ në gjuhën shqipe. E bashkë me të zvogëlohet mjaft edhe probabiliteti i vendosjes së kushteve fonologjike në zhvillimet e hershme të spirantes ie. */s/në gjuhën shqipe.

Sic del edhe nga sa u parashtrua në këta paragrafë për përcaktimin e kushteve të zhvillimit të spirantes ie. */s/ para një zanoreje, rol të rëndësishëm ka luajtur pozicioni burimor i theksit. Në përputhje me vendin e theksit për çdo njësi vërtetohen dy reflekse : a) ie. */s/ → shq. /ʃ/ / — V — dhe b) ie. */s/ → shq. /g/ / — V —. Një refleks i tretë ie. */s/ → shq. /θ/ përcaktohet në dy raste sporadike, si një dukuri disimilimi, e kushtëzuar nga prania e një spiranteje tjeterë në strukturën burimore. Ndërsa zhvillimi i supozuar ie. */s/ → shq./h/ mbetet sot për sot i pavërtetuar bindshëm.

Zusammenfassung

BEMERKUNGEN ZU DEN REFLEXEN DES IDG.*/S/ IM ALBANISCHEN

Die Entwicklung des Spiranten */s/ im Albanischen ist stets in engem Zusammenhang mit der Stellung des Wortakzentes gesehen worden, wofür verschiedene Sprachforscher zwei Hauptreflexe festgestellt haben: a) */s/->alb./ʃ// — V — : */septn/ > *shta*(të) «sieben», */sēkv-/ (Aoriststamm) > *shoh* «ich sehe» usw.; b) */s/ → alb. /g// — V — : */seks/ > *gjash*(të) «sechs», */súpno-/ > *gjumë* «Schlaf», */sérpen-/ > *gjarpér* «Schlange» usw. Ein dritter Reflex dieses Spiranten, */s/ → alb./θ/, der nur in zwei einzigen Fällen vorkommt: */süs/ > *thi* «Schwein», */saus-njō-/ > *thoj* «ich trocke», könnte man als Ergebnis einer dissimilatorischen von der Anwesenheit eines zweiten */s/ in der ursprünglichen Wortstruktur bedingten Erscheinung erklären.

In der diachronischen Untersuchung hat man noch einen weiteren Reflex: */s/ → alb./h/ behauptet, der als eine spätere Entwicklung der Veränderung */s/->/ʃ/ vor einem hinteren Vokal (/a/, /o/, /u/) beachtet worden ist: */solkjō-/ (?) > *heq* «ich ziehe», */sulno-/ (?) > (*h*)yll «Stern»; */sodinjō-/ (?) *hyj* «eintreten» u.dgl. Manche Sprachforscher sind ohnedies selbstbewusst, dass gewisse lexikalische Einheiten dieser letzten Vermutung nicht entsprechen. Das gibt dem Forscher den guten Anlass, sich mit der Richtigkeit dieser behaupteten Veränderung weiter zu befassen.

Auf Grund einer detaillierten Analyse auf der phonologischen und der etymologischen Ebene ist der Verfasser dieses Aufsatzes zu dem folgenden Abschluss gekommen, dass die vermutete Entwicklung */s/->alb./h//. — /a/(/o/,/u/) heutzutage unbewissen bleibt.

1. In ähnlichen tonemischen Bedingungen wird die phonologische Entwicklung */s/->alb./h/ auch vor einem hinteren Vokal bestätigt : Lok. Pl. Endung */-su/ > -sh, */sū-oī/ > *shi* «Regen», */sek-tV/ > *shatē* «herzförmige Hacke», */hjem/ > *jeshē* «ich war».

2. Alle Fälle, die für die Entwicklung */s/->/h/ am sichersten behauptet worden sind, brauchen gerade einer weiteren etymologischen Untersuchung zu unterziehen, die auf Grund der neuen linguistischen Daten, die Abwesenheit eines */s/ in der betreffenden Wortstruktur ausser Zweifel legt: *heq* < */uelkjō-/ , (*h*)ec < *uendhjō-/ , (*h*)yll > */uslo-/ u.dgl.

3. Das Phönem /h/ in diesen Einheiten, das hauptsächlich in einigen Mundarten hervorkommt ist in den meisten Fällen als ein späterer inorganischer Laut zu beachten (vgl. auch die Entlehnungen: lat. *admissarius* > *hamëshor* «Pferd», sud. sl. *vabel* > *harabel* «Sperling»). Es gibt aber noch gewisse Einheiten, in denen dieses Phönem als Ergebnis anderer phonologischer Entwicklungen hat entstehen lassen.

42) Shih H.Barić, *Albanorum. Studien*, I, Sarajevo, 1919, f.17.

43) Shih H.Ölberg, *Einige Überlegungen zur Laringaltheorie an Hand des Albanischen*. KZ 86, f.121; E.Çabej, SE, *fjala hyj (e pabot.)*

44) Shih E.Hamp, *Evidence*. f.125; M.Huld, *vep. cit.* ,f.151.